

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 11.10.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “ Ulje e pagës deri në 40%, deri në 1 vit” ndaj gjyqtarëve P.A. dhe N.T.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar hetimin disiplinor ndaj magjistratëve P.A. dhe N.T. me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, bazuar në vendimin e KLGJ për rikthim për hetim pranë ILD-së, të vendimit të arkivimit të hetimit ndaj dy magjistratëve nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kontekst: Kjo çështje është pjesë e ankesave, që ILD ka trashëguar nga institucionet e tjera (KLGJ në këtë rast), të cilat po trajtohen me përparësi për të shmangur kulturën e pandëshkueshmërisë apo harresës për shkelje të paraqitura ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Shtetasi J. XH, me nismën e të cilit ka filluar hetimi disiplinor, ka ankimuar më 26.09.2018 vendimin e Inspektoratit të KLD-së, për arkivimin e ankesës së bërë prej tij, ndaj magjistratëve P.A. dhe N.T. Komisioni i përkohshëm i KLGJ-së për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektoratit Këshillit të Lartë të Drejtësisë, më 16.07.2019 vendosi pranimin e ankimit, duke prishur vendimin e arkivimit të ankesës nga Inspektorati i KLD-së për gjyqtarët e Apelit Vlorë dhe dërgimin e praktikës në ILD, në momentin e krijimit të këtij institucioni.

Në kuadër të hetimit disiplinor, u konstatua se ndaj R.A., në vitin 2015, ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, e cila nuk u ekzekutua. Më 21.08.2016, mbrojtësi i tij kërkoi zëvendësimin e masës, kërkesë e shqyrtuar nga një gjyqtar i gatshëm dhe jo nga trupi gjykues që shqyrtonte themelin e çështjes. Më 22.08.2016, Gjykata e Rrethit Vlorë e zëvendësoi masën me “detyrim paraqitje”. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë më 22.09.2016, ndërsa Prokuroria paraqiti rekurs duke kërkuar rikthimin e masës “arrest në burg”.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohet se:

- Magjistratët P.A. dhe N.T. kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, shkelje e konstatuar edhe nga një gjykatë më e lartë.
- Ata kanë shkelur nenin 260, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos respektuar kompetencën e gjykatës që shqyrton themelin e çështjes për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit.
- Shkeljet janë vlerësuar si të kryera me dashje direkte, pasi magjistratët kanë mbajtur qëndrim në kundërshtim me ligjin dhe nuk kanë shqyrtuar e argumentuar siç duhet kërkesat e prokurorit, pavarësisht formimit dhe përvojës së tyre.
- Veprimet e tyre kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë dhe kanë cenuar detyrimin për zbatim rigoroz të ligjit dhe rregullave procedurale.
- Sjellja e tyre ka cenuar imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut te gjyqësori.

Raporti hetimor konkludon se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratëve përbëjnë “Shkelje të rëndë disiplinore” dhe i propozohet KLGJ-së, caktimi ndaj magjistratit N.T. gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe magjistratit P.A., gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë (i pezulluar), i masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të

gjatë se një vit” parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.